



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VIII

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

Mbledhja nr.101

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

Prishtinë, më 4 tetor 2024, në orën 10:00

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë : Fatmire Kollçaku, Armend Zemaj, Labinotë Demi- Murtezi, Haxhi Avdyli, Mirsad Shkreta, Burim Meta, Bekim Haxhiu dhe Floretë Zejnullahu, dhe Shemsedin Dreshaj, anëtarë.

Mungoi : Samra Ilijazi, anëtarë.

Pjesëmarrës i ftuar : Dr. Arben Vitia, ministër i Ministrisë së Shëndetësisë.

Stafi mbështetës : Shpresa Haxhijaj, koordinatore dhe Besim Haliti, zyrtar i lartë/analist.

Pjesëmarrës tjerë : Naim Bardiqi, Erza Gashi, Durim Elshani -MSH; Violeta Salihu – Emini nga KSHMS-ja .

Mbledhjen e kryesoi Fatmire Kollçaku, kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës: 12.9.2024;**
- 3. Takimi me ministrin e Ministrisë së Shëndetësisë, z. Arben Vitia**
Temat : Strategjia Legjislative e Ministrisë së Shëndetësisë;
Zhvillimet aktuale në sektorin e shëndetësisë.
- 4. Të ndryshme.**

1.Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2.Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës: 12.9.2024;

Procesverbali i mbledhjes së datës 12.9.2024 u miratuan pa vërejtje

3.Takimi me ministrin e Ministrisë së Shëndetësisë, z. Arben Vitia Temat : Strategjia Legjislative e Ministrisë së Shëndetësisë; Zhvillimet aktuale në sektorin e shëndetësisë

Fatmire Kollçaku, tha së edhe Planin e Punës së Komisionit, për sesionin vjeshtor 2024, e kemi pasur të planifikuar për muajin tetor, për ta ftuar ministrin e Shëndetësisë z. Arben Vitia, i cili ju ka përgjigjur ftesës pozitivisht, lidhur me këtë rend të ditës po ia kalojmë fjalën për ta paraqitur ekspozitën sa i përket këtyre temave.

Arben Vitia, ministër i Ministrisë së Shëndetësisë: Në këtë thirrje është theksuar kërkesa për diskutimin e legjislacionit dhe zhvillimeve të tjera gjatë këtyre muajve në Ministrinë e Shëndetësisë dhe institucionet për këtë fushë. Gjatë raportimit të 2 shkurtit të këtij viti kemi diskutuar bashkërisht për projektet që i kemi pasur të planifikuara për vitin 2024.

Shumica dërrmuese e tyre tanimë janë të kryera. Dhe çdo projekt i planifikuar tanimë është futur në proces të pakthyeshem. Atë që kam thënë edhe më herët, do të doja të theksoja përsëri për ju të nderuar deputetë se proceset reformatore janë shumë e rëndësishme të jenë me nisma bazuar në analizë dhe evidencë dhe rezultate të pakthyeshme. Në këtë drejtim më lejoni të paraqes para jush disa nga masat konkrete që i kemi ndërmarrë dhe po i ndërmarrim në raport të ndërhyrjeve që kemi bërë në sistem. Në legjislacion, infrastrukture, furnizime të qëndrueshme me barna si dhe resurset njerëzore. Sa i përket Legjislacionit, deri tani kemi miratuar 4 ligje dhe 20 akte nënligjore. Ligjin nr. 08/L-220 për çmimin e produkteve medicinale; (3.8.2023); Ligjin nr. 08/L-200 për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjeve ngjitëse; Projektligjin për sigurime shëndetësore me 28.8.2024, është miratuar në Qeveri; Projektligjin për Shëndet Riprodhues dhe Fertilizim të Asistuar Mjekësor, është aprovuar në parim nga Kuvendi i Kosovës. Si dhe projektligji për Shëndetësinë, Inspektoratin Duhanin, tanimë janë në konsultime paraprake dhe diskutime publike. Pas hyrjes në fuqi të ligjit për përcaktimin e çmimit të barnave në gushtin e vitit të kaluar, përkundër shumë sfidave, ky ligj është në rrugë të mirë për të nisur zbatimin e plotë. Duke ditur se kjo është një nga çështjet më të rëndësishme në reformën në shëndetësi dhe po ashtu, duke ditur se një proces i tillë po bëhet për herë të parë në vendin tonë ka pasur vëmendjen tonë maksimale në çdo hap të kryer. Shfrytëzoj edhe njëherë t'ju falënderoj për mbështetjen që ja keni dhënë këtij ligji por edhe për kritikën dhe sugjerimet që keni bërë gjatë kësaj kohe. Ligji për shëndetin riprodhues dhe fertilizim të asistuar mjekësor, tani më po bëhen më shumë se një vit e gjysmë që ky ligj nuk po kalon në parlament në lexim të dytë. Përkundër të gjitha kritikave dhe keqkuptimeve, ky ligj plotëson kriteret kryesore për një bazë të mirë që këtë çështje kaq të rëndësishme për çiftet tona të kemi mundësinë ta vëmë në binarët ligjorë, me sanksionet përkatëse por jo vetëm. Siç e dimë, me UA aktual kjo çështje është e pamundshme të rregullohet si duhet dhe e kemi të domosdoshëm një ligj i cili adreson në mënyrë të duhur të gjitha problemet e hasura në terren, por edhe brenda kornizave dhe direktivave të EU-së. Pa këtë ligj, po vazhdon që kjo procedurë të kryhet edhe në Kosovë por sidomos jashtë Kosovës duke bërë që çiftet të harxhojnë me qindra mijëra euro në vendet e rajonit por jo vetëm. Kemi pasur edhe diskutime publike për këtë ligj bashkë edhe me ju deputetët të nderuar dhe mendoj se nuk ka asnjë arsye që ky ligj të mos votohet. Dhe po ja lejoj vetes edhe njëherë që të kërkojë nga ju që në mbledhjen e ardhshme të Kuvendit të Republikës ta mbështetni këtë ligj vital për çiftet dhe familjet tona. Ligji për sigurimin e detyrueshëm shëndetësor – tani më duke ju falënderuar këtij komisioni të nderuar shpresoj shumë shpejtë të procedohet në parlamentin e Republikës. Shpresoj dhe bëjë thirrje se të gjithë deputetët do të votojnë për këtë ligj kaq të rëndësishëm për sistemin shëndetësor. Ligji për shëndetësi – tani më është në fazën e konsultimeve paraprake dhe shumë shpejtë pastaj edhe në diskutimet publike. Me padurim presim komentet dhe sugjerimet nga të gjitha palët e interesit. Projektligji për

Produkte dhe pajisje medicinale – ky ligj tani më ka mbaruar drafti final dhe po pritet që të fillojnë konsultimet paraprake. Ky ligj përcakton rregullat për hulumtimin klinik dhe vendosjen në treg, prodhimin, etiketimin, klasifikimin, tregtimin, farmakovigjilencën, kontrollin e cilësisë, reklamimin, furnizimin e tregut me barna, monitorimin e barnave, barnave në hulumtim, substancave aktive dhe ndihmëse. Është një ligj shumë i rëndësishëm që bashkë me ligjin për tavanin e çmimeve të barnave të vendosë rregull në sektorin farmaceutik dhe është pjesë e rëndësishme e reformave në shëndetësi. Në këtë ligj ka pasur direktiva të shumta nga EU-ja, të cilat është dashur të adresohen dhe përkundër asaj se grupi punues ka punuar për një kohë të gjatë në këtë ligj, ka pasur pengesa të cilat tanimë janë tejkaluar. Projektligji për Prodhimin, Prezantimin dhe Shitjen e duhanit dhe produkteve të ngjashme- tanimë ka kaluar konsultimet paraprake dhe është në diskutime publike. Me këtë ligj rregullohet kultivimi, përpunimi, grumbullimi, prodhimi, tregtimi, kontrolli, klasifikimi i duhanit, produkteve të duhanit si dhe produkteve të ndërlidhura.

Ky ligj përcakton masat për reduktimin dhe kufizimin e përdorimit të duhanit dhe produkteve të tij, si dhe produkteve të ndërlidhura, etiketat e detyrueshme në paketimet e tyre dhe masat parandaluese kundër pirjes së duhanit. Edhe pse kemi qenë në proces të hartimit të këtij ligji, siç jeni të informuar tashmë – për shkak të rëndësisë dhe ruajtjes së shëndetit publik, kemi hartuar UA për vërejtjet e kombinuara dhe nga 1 shtatori pakot e duhanit tani më kanë filluar të hyjnë në Republikën e Kosovës me fotografi dhe mesazhe të cilat tregojnë me tekst dhe fotografi për dëmet që shkakton pirja e duhanit. Ky ligj po ashtu, i rëndësishëm për shëndetin publik, pritet që menjëherë pas diskutimeve publike të procedohet në qeveri dhe pastaj në këtë komision të nderuar. Është një ligj që ka shumë kohë që është munduar të ndryshohet dhe gjatë hartimit të tij ka pasur ekspert të ndryshëm të fushës dhe po ashtu, në bazë të direktivave të EU – do të jetë një ligj i përditësuar që i përgjigjet kohës dhe rrethanave edhe në Republikën tonë, në mënyrë që të jetë i zbatueshëm në tërësinë e tij. Projektligji për shëndetin mendor -Gjatë vitit 2023 është punuar për adresimin e Rekomandimeve të Kuvendit të Kosovës. Mirëpo, meqenëse projektligji ka pasur paqartësi dhe dykuptimësi të roleve dhe përgjegjësive të Institucioneve që ofrojnë shërbime të shëndetit mendor, dhe me qëllim të rregullimit sa më mirë të kësaj fushe specifike që ndikon direkt në mbrojtjen e të drejtave të personave me çrregullime mendore dhe parandalimin e abuzimeve në trajtim - e kemi vlerësuar nevojën për mbështetje me ekspertizë ndërkombëtare nga mekanizmi i Komisionit evropian TAIEK, që ofron ekspertizë në hartimin e legjislationit për vendet që janë në proces të integritimit në BE. Eksperti do të fillojë angazhimin në muajin e ardhshëm, pra, në muajin nëntor 2024. Projektligji për Inspektoratin Qendror të Shëndetësisë, tashmë është në diskutime publike dhe së shpejti miratohet në qeveri dhe procedohet në Kuvend. Ky projektligj ka për qëllim themelimin, organizimin, kompetencat dhe funksionimin e Inspektoratit Qendror të Shëndetësisë. Përmes këtij Projektligji do realizohen: Inspektimet e institucioneve dhe profesionistëve shëndetësorë; Inspektimin e prodhuesve, importuesve, qarkulluesve me shumicë dhe pakicë të produkteve medicinale, pajisjeve medicinale dhe profesionistëve farmaceutik; Inspektimet sanitare që kanë për qëllim mbrojtjen e shëndetit publik dhe Inspektimet e preparateve vitaminoze, dietale dhe kozmetike me veprim terapeutik; Këto janë konkluzionet e punës shumë të gjatë me të gjitha trajtimet e nevojshme për nismat ligjore. Sigurisht që do të ketë këtu polemika për kalendarin e ardhjes në Kuvend të këtyre projektligjeve. Por, ajo çfarë duhet t’ju njoftoja është se koha e ardhjes së tyre lidhet me punën paraprake që është dashur të kryhet para se të hyjmë në një ndryshim ligjor që përbën reformë dhe që adreson në masë të madhe të gjitha fenomenet që janë vënë re në fushën që mbulon. Po vijoj me çështjet të cilat lidhem më sistemin spitalor të vendit, lidhur më infrastrukturën dhe shërbimet Klinika e Onkologjisë, Në Klinikën e Onkologjisë kemi bërë investime në katër fusha: Aparaturë, infrastrukturë, shërbime të reja dhe në barna esenciale Akselatori i ri në vlerë 1 milionë e 444 mijë euro. I dyti gjatë mandatit tonë. Kjo aparaturë mundëson rritjen e cilësisë së shërbimeve si dhe ka ndikuar drejtpërdrejtë në eliminimin e listës së pritjes për terapinë rrezatuese. Po ashtu, akselatorit të ri i është shtuar edhe sistemi i avancuar laserik C-RAD i cili mundëson saktësi maksimale në rrezatim dhe është i vetmi i tillë në rajon.

Kemi bërë transformim rrënjësor të klinikës në vlerë 550 mijë euro, si: Riorganizim të hapësirave të cilat tashmë janë komode dhe të përshtatshme si për stafin ashtu edhe për pacientët. Po ashtu, numri i shtretërve është rritur për 120%, nga 45 sa ishin, tani janë 110 shtretër. Për herë të parë klinika është pajisur me klimatizim dhe digjitalizim të shërbimeve. Rritja e gamës së Listës së Barnave Esenciale për pacientët me sëmundje malinje është rritur për 5 milion euro, nga rreth 8 milion euro sa ishte në 2019-ën, në revidimin e fundit është rritur në 13 milionë euro. Pacientëe me sëmundje malinje për të ju bërë sa më të lehtë qasjen në terapi tabletare kemi decentralizuar shërbimet, tani terapia tabletare ofrohet edhe në Prizren. Klinika e Oftalmologjisë Në klinikën e Oftalmologjisë kemi investuar 550 mijë euro në pajisje që janë fjala e fundit e teknologjisë, përmes të cilave po bëhet diagnostikim e trajtim shumë më cilësor e më preciz. Gjithashtu, nga ky investim janë shtuar edhe shërbimet e reja si: Shërbimi: Retinopatia Oftalmike te prematurët e cila shërben për ekzaminim të segmentit të pasmë të syve tek fëmijët, sidomos tek të porsalindurit dhe atyre të lindur para kohe si dhe për diagnostikim të retinopatisë të premtuarit – ROP. Pacientët të cilët i nënshtrohen këtij trajtimi duhet të monitorohen, dhe tek ato raste që kanë nevojë, duhet te bëhet trajtimi urgjent në: Sallën operative me aplikim të Anti VEGF (Aplikimi intravitreal në segmentin e pasmë të syve); intervenim kirurgjik PPV (Pars Plana Vitrectomy). Është zvogëluar numri i pacientëve që trajtohen jashtë institucioneve shëndetësore publike, nga mbi 500 raste të referuara në vit, tani referohen rreth 100 (rreth 1.6 milion euro kursime në vit mbi 6 milion euro jane kursyer për 4 vitet e fundit, për trajtime jashtë vendit, e me këtë kemi kursyer mijëra euro nga xhepi i pacientëve si dhe miliona euro nga arka e shtetit.) Renovimet në infrastrukturë: Reparti A dhe B janë transformuar tërësisht, si dhe sallat operative. Sporteli dhe ambulanca janë në proces të renovimit dhe shume shpejte priten të përfundojnë. Për të vazhduar pastaj edhe me repartin C dhe D. Klinika Gjinekologjisë- Investime mbi 5.5 milion euro në transformimin e reparteve të Klinikës së Gjinekologjisë. Riorganizimi i reparteve ku dhomat e pacienteve nga 8 deri në 10 shtretër sa ishin tani sipas standardeve janë nga dy shtretër. Tani dhomat janë pajisur me banja dhe nyje sanitare. Po ashtu, për herë të parë është vendosur ventilimi qendror dhe klimatizimi në reparte. Për herë të parë kemi digjitalizim të shërbimeve në ambulancën specialistike. Riorganizim i sporteleve dhe hapësirave pritëse për pacientet. Kanë përfunduar investimet në repartin e Fertilizimit të asistuar – FAM, dhe tashmë kanë arritur edhe pajisjet e reja për këtë shërbim të ri, i cili do të ofrohet falas në shëndetësinë publike Krahas këtyre investimeve po shtohen edhe shërbime të reja të munguara deri më tani ne institucionet tona publike të cilat do të ndikojnë direkt në cilësinë e jetës së pacienteve dhe do të kursejnë xhepin e qytetareve tanë. Shërbimet e reja: Fertilizimi i asistuar mjekësor; Mjekësia fetale dhe Amniocenteza. Klinika e Urologjisë - Në Klinikën e Urologjisë më shumë se dy dekada nuk ka pasur investime, andaj kemi fillua me renovimet rrënjësore aty ku më së shumti ka nevojë. Vlera e investimeve është mbi 1.2 milion Euro. Riorganizim i dhomave dhe shtim të numrit të shtretërve. Për herë të parë është instaluar sistemi për thirrjen e infermiereve nga pacientët “call nurse”, Instalimi i oksigjenit në te gjitha dhomat për pacientë, dhe klimatizimi i hapësirës. Nyjat sanitare tani janë me kushte e standarde moderne dhe është shtuar edhe banja për persona me aftësi të kufizuara (nga 2 në 3) Dyert e pacientëve janë zgjeruar nga 1m në 1.20m sipas standardit për shtretër të pacientëve. Riorganizimi i hapësirave të bllokut operativ: Filtrat steril për herë të parë për parandalimin e infeksioneve brenda spitalore. Kanë qenë 2 salla, dhe tani janë 4 salla, d.m.th. kemi riorganizim te bllokut operativ ne Urologji ku njëra sallë do të shërbej për intervenimet e vogla dhe tjetra do të shërbej për ndërhyrjet endourologjike. Po ashtu, është instaluar sistemi i oksigjenit, është bërë funksionalizimi i plote i sistemit te ventilimit dhe ngrohjes, dyert me hapje automatike dhe akses kontrollë. Me riorganizimin e bllokut operativ do të ulen listat e pritjes po ashtu, janë krijuar kushtet për shërbime të reja të cilat do të ndikojnë drejtpërdrejt në uljen e referimeve për trajtim jashtë vendit. Transformimi i Bllokut Operativ në Kirurgjinë Torakale: Hapësira moderne sipas standardeve bashkëkohore për sallat operative. Aparatura dhe metoda të reja që nuk janë përdorur më parë në vendin tonë. Filtër zona për eliminimin e infeksioneve intrahospitalore. Aparatura për fiksimin e brinjëve – për herë të parë në Klinikën e Kirurgjisë Torakale. Aparatura për gjurmimin

e nyjave limfatike – veçanërisht për karcinomën e gjirit dhe melanomën malinje. Aparatura më e re Nuss – Procedurë e realizuar me VATS, me rezolucion shumë të lartë për ndërhyrje kirurgjike në regjionin e krahavorit. Sternotomi elektrike – deri më tani është realizuar në mënyrë mekanike, me çekan; tash e tutje me metodë elektrike për ndërhyrje më të shpejtë dhe më të saktë.

Adoleshentëve në Klinikën e Psikiatrisë. Ky investim përfshinë: Riorganizim të hapësirës, investime në dritare, çati, izolim, ndriçim e sistem të ngrohjes. Për herë të parë Reparti bëhet me shtretër për hospitalizim. Është shtuar shërbimi për Logopedi. Instituti Special Shtime- janë renovuar tërësisht dy reparte ku janë përmirësuar shërbimet për 60 rezidentë me çrregullime të shëndetit mendor. Janë krijuar hapësira rekreative, janë rregulluar korridoret dhe kthinat, dyshemeja dhe është vendosur ndriçimi. Vlera e këtij investimi është 70,157.00 euro Ky investim është një investim i domosdoshëm dhe paralelisht jemi ne procedura qe ky institut te ndërtohet nga fillimi me kushtet dhe shërbimet me bashkëkohore për këtë kategori. Qendra Rajonale e Shëndetit Publik në Prizren- Prej një objekti thuaj se jo-funksional në një objekt modern. Investim në paisje dhe në infrastrukture. Ky investim kap vlerën e 81.362 euro. Klinika e Nefrologjisë dhe Hemato-Onkologjisë U vendos gurthemeli për klinikat e reja të Hemato Onkologjisë dhe Nefrologjisë. Ky projekt në vlerë prej 4,299,293.31 Euro, do të krijoj hapësira dhe standarde moderne për pacientët.

Sipërfaqe prej 3760 m², me këtë investim sigurohet më shumë cilësi e më shumë shërbime. Për herë të parë në këtë klinikë do të ofrohet shërbimi i Plazmaferezës dhe po angazhohemi që të ofrohet edhe biopsia e veshkës. Në Klinikën e re do të bëhet transplantimi autolog i palcës kockore tek leukemitë akute gjë që nuk është bërë deri më tani për shkak të kushteve dhe pacientët janë dërguar jashtë vendit për trajtim dhe transplantim të palcës kockore. Klinika e Ortopedisë- Mbi 2.8 milion euro investime që përfshijnë: Objekt i ri me sipërfaqe prej 3485 m² Tre reparte, secili me barnatoren e vet. 4 salla operative. 22 dhoma për pacientë. 44 shtretër gjithsej Instalimi i sistemit "call nurse" për thirrjen e infermierëve nga pacientët. Tualete për secilën dhomë, përfshirë tualete për persona me aftësi të kufizuara. Klimatizim dhe ventilim qendror. Ujin sanitar me panele diellore. Nënstacion i gastave medicinale, ku janë instaluar sistemi i oksigjenit medicinal, oksidulit, ajrit të komprimuar dhe vakumit. Pediatria e vjetër me masat e efijencies- Ne kuadër të projektit të efijencies nga Ministria e Ekonomisë në objektin e pediatriisë se vjetër janë kryer këto pune: Izolimi termik; Gëlqerosja; Dritaret dhe dyert e reja; Instalimi i pompave te reja ri-qarkulluese te ngrohjes. Instalimi i valvuleve të reja dinamike dhe termostatike në radiator të klinikes dhe furnizimi dhe montimi i ndriçuesve LED Për fund sa i përket investimeve në infrastrukture vetëm për informacionin e juaj, këto investime do të vazhdojnë në spitalet e përgjithshme. Kjo, sepse përkundër investimeve ne QKUK për shkak të mos investimeve shumëvjeçare në Spitalet e Përgjithshme dhe kushteve joadekuate ka referime shpeshherë të panevojshme në QKUK. Me këto investime që presim t'i bëjmë në spitalet e përgjithshme, do të ulet fluksi i pacientëve në QKUK, duke lehtësuar kështu ngarkesën atje. Qytetarët e këtyre regjioneve do të kenë mundësi të marrin shërbime me të njëjtën cilësi edhe në spitalet e përgjithshme.

Qendra Stomatologjike Universitare ka krijuar shërbime të reja, duke përfshirë shërbimin e sedacionit inhalator, i vetmi në rajon brenda sistemit publik të shërbimeve dentare. Ky shërbim është veçanërisht i rëndësishëm për fëmijët, sidomos ata me aftësi të kufizuara dhe ata që vuajnë nga ankthi gjatë procedurave stomatologjike.

Në Kirurgjinë Torakale, është futur procedura VATS me nënprocedurën NUSS, një teknikë kirurgjike minimal invasive që realizohet për herë të parë në institucionet tona publike. Kjo procedurë do të ndihmojë në kursimin e shpenzimeve publike, pasi deri tani këto ndërhyrje dërgoheshin për trajtim jashtë vendit me një kosto prej 35 mijë eurosh për rast. Pritet që kjo të sjellë kursime rreth 700 mijë euro në vit.

Kirurgjia Plastike ka bërë përparime të dukshme, duke realizuar për herë të parë mbi 100 implante të gjirit dhe mbi 50 ekspander, si dhe rikonstruktimin e gjirit, të gjitha këto pa pagesë, ndërsa në sektorin privat këto shërbime kushtojnë midis 3,000 dhe 5,000 euro.

Në Klinikën e Kardiologjisë, është funksionalizuar shërbimi i ri në njësinë e elektrostimulimit dhe elektrofiziologjisë, duke përdorur metodën e ablacionit me radiofrekuencë me një sistem modern të navigacionit 3D. Kjo do t'i lejojë qytetarët të marrin shërbime që më parë ishin të detyruar t'i kërkonin jashtë vendit.

Këto investime dhe shërbime të reja përfaqësojnë një hap të rëndësishëm drejt përmirësimit të cilësisë së kujdesit shëndetësor në vend.

Shërbimet e reja në Klinikën e Gastroenterologjisë kanë sjellë përmirësime të rëndësishme për qytetarët, duke u mundësuar atyre që të kursejnë shpenzime të mëdha për shërbime në institucione private. Një nga shërbimet e reja është Ultrazëri Endoskopik (EUS), një trajtim minimal invaziv që kombinon endoskopinë dhe imazhin me ultratinguj, duke ofruar informacione të detajuara për traktin tretës dhe organet përreth. Shërbimi tjetër, Kapsula Endoskopike, lejon ekzaminimin jo invaziv dhe gjithëpërfshirës të traktit tretës, duke ndihmuar profesionistët shëndetësorë të marrin imazhe të detajuara të zorrëve të holla, të cilat ishin të vështira për t'u qasur më parë.

Në Spitalin e Përgjithshëm të Prizrenit, shërbimi i Kardiologjisë Intervente është tani i disponueshëm, duke eliminuar nevojën për qytetarët të udhëtojnë në Prishtinë për trajtim. Ky shërbim përdor teknika të avancuara për ndërhyrje brenda enëve të gjakut, zhblokimin e arterieve koronare, vendosjen e stentave dhe përmirësimin e qarkullimit të gjakut. Investimi për këtë shërbim arrin afërsisht 3 milion euro.

Në Spitalin e Përgjithshëm të Gjakovës, janë bërë investime të shumta në Repartin e Syve, ku ka filluar operimi i kataraktës me metodën moderne të fakoemulsifikimit. Kjo do të ndikojë pozitivisht në buxhetin familjar, pasi shërbimi në sektorin privat kushton 600-800 euro. Plani është që kjo procedurë të fillojë së shpejti edhe në Spitalin e Pejës.

Një tjetër arritje është sigurimi i pajisjes PET-CT në QKUK, e vetmja në rajon për shëndetësinë publike. Falë angazhimit të Presidentes Osmani dhe ish-Presidentes Jahjaga, është bërë renovimi i hapësirave të mjekësisë Nukleare me një investim rreth 200 mijë euro. Kjo do t'i kursejë buxhetit të Republikës rreth gjysmë milioni euro në vit, pasi më parë qytetarët ishin të detyruar të udhëtonin jashtë vendit për këtë shërbim.

Për më shumë se 20 vjet, qytetarët kanë pasur akses vetëm në dy aparatura MRI në institucionet publike, duke krijuar lista pritjeje deri në një vit. Tani, janë shtuar tre aparatura të reja në Spitalin Rajonal të Pejës, Klinikën e Pediatrisë dhe Spitalin e Prizrenit, duke reduktuar listat e pritjes në rreth 4-6 javë.

CT 128 në Klinikën e Radiologjisë, një donacion nga Zyra për Bashkëpunim në Mbrojtje pranë Ambasadës Amerikane, ofron diagnostikim të saktë dhe shpejtësi në skanim. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për pacientët me kundërindikacione për koronarografi.

Po ashtu, është vendosur një shërbim i ri në shëndetësinë publike për screeningu neonatal, që zbulon në kohë çrregullime të ndryshme dhe sëmundje të fshehta, duke siguruar kujdes më të

mirë për foshnjat. Këto investime dhe shërbime të reja kontribuojnë në përmirësimin e cilësisë së kujdesit shëndetësor për qytetarët, në mbrojtje të shëndetit mendor e fizik të fëmijëve.

Ky screening është jashtëzakonisht i rëndësishëm, pasi ndihmon në detektimin e hershëm të patologjive, çka mund të parandalojë dhe trajtojë më efektivisht sëmundjet, duke kursyer vuajtje për familjet dhe duke ulur kostot për buxhetin familjar dhe shtetëror. Investimi prej 6.4 milionë euro për pajisje në ndihmë të personave me aftësi të kufizuara është një hap historik, realizuar për herë të parë nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Ky projekt, i mbështetur nga Udhëzimi Administrativ i Ministrisë së Shëndetësisë, është pjesë e iniciativave për vitin e personave me aftësi të kufizuara, shpallur nga Qeveria Kurti, dhe do të realizohet në dy vite, me 3.2 milionë euro investim në çdo vit.

Vazhdon edhe pajisja e Shërbimit Shëndetësor të Kosovës me autoambulanca të reja, të cilat janë të pajisura me të gjitha mjetet e nevojshme për situata të ndryshme, duke përmirësuar kështu sigurinë gjatë transportit të pacientëve. Për herë të parë, është siguruar edhe autoambulanca neonatale për foshnjat e posalindura, e cila ofron qasje të shpejtë në kujdesin intensiv.

Në fushën e fertilizimit in vitro (IVF), janë arritur pajisjet e nevojshme dhe është duke u trajnuar stafi shëndetësor, me synimin që shërbimi të fillojë brenda vitit. Laboratori citogjenetik për IVF gjithashtu është në proces, me një investim prej 200,000 eurosh.

Për kujdesin parësor shëndetësor, Ministria e Shëndetësisë ka furnizuar 30 komuna me automjete për vizitat e nënave dhe fëmijëve, si dhe vaksinimin e fëmijëve sipas kalendarit të rregullt. Ka filluar gjithashtu krijimi i regjistrit të qytetarëve përmes platformës shtetërore e-kosova, që do të ndihmojë në rritjen e mbulueshmërisë me shërbime shëndetësore.

Në lidhje me resurset humane dhe specializimet, janë hapur 588 specializime të reja për profesionistët shëndetësorë, si dhe një konkurs për sektorin privat për 56 specializantë të rinj. Po ashtu, janë aprovuar 299 pozita për mjekë familjarë, me një buxhet prej 2.4 milion euro për paga.

Numri i specialistëve në Sistemin Tretësor Klinik Universitar është rritur me rreth 240 specialistë në tri vitet e fundit, dhe pritet që numri i infermierëve të rritet me 200 të tjerë gjatë këtij viti.

Këto përmirësime janë mbështetur edhe nga një rritje e kapaciteteve inspektuese, me 35 inspektorë të rinj. Lista e barnave esenciale është rritur dukshëm, me një buxhet që është shumëfishuar që nga viti 2019, duke lehtësuar kështu qasjen në medikamente të nevojshme për qytetarët.

Inspektorati Shëndetësor ka shumëfishuar kapacitetet e tij inspektuese, duke shtuar 35 inspektorë të rinj, nga të cilët 24 janë për inspektoratin shëndetësor dhe 11 për atë farmaceutik.

Në lidhje me listën e barnave esenciale, buxheti ka shënuar një rritje të dukshme në vitet e fundit. Për shembull, në vitin 2019, buxheti për këtë listë ishte 35.857.473 euro, ndërsa në vitin 2021 u ul në 21.579.679 euro. Megjithatë, në vitin 2023, buxheti është rritur në 59.161.734 euro dhe për vitin 2024 parashikohet të arrijë 63.366.000 euro. Kjo rritje ka lejuar zgjerimin e gamës së produkteve, duke shtuar 70 produkte të reja dhe duke përfshirë edhe barnat për procedurat e IVF-it.

Përditësimet në listën e produkteve mjekësore dhe materialeve shpenzuese janë bërë më shumë se një herë që nga nënshkrimi në maj 2023. Gjatë vitit 2023, buxheti për listën esenciale të

barnave dhe materialeve shpenzuese për kujdesin parësor shëndetësor është dyfishuar, duke kaluar nga 11 milion në 21 milion euro.

Furnizimi me barna nga lista e barnave esenciale është rreth 70%, ndërsa furnizimi me material shpenzues është mbi 90%. Për insulina, përqindja e furnizimit është 100%. Në vitin 2024, lista e barnave esenciale përmban 886 produkte farmaceutike dhe 478 materiale shpenzuese medicinale, duke e bërë këtë listë më të plotë dhe më të dobishme për qytetarët që kanë nevojë.

Vaksinat dhe imunizimi janë thelbësore për ruajtjen e shëndetit publik. Buxheti për vakcina është pesëfishuar, duke kaluar nga 1 milion në 6 milion euro. Pas një dekade, kalendari i vaksinimit është përditësuar dhe janë shtuar tri vakcina të reja, të cilat janë të rëndësishme për shëndetin e qytetarëve: vakcina HPV, vakcina e pneumokokut dhe vakcina e rotavirusit.

Për vitin 2024, SHSKUK ka arritur një përqindje furnizimi prej 74% për produkte mjekësore dhe 83% për materialet. Për pacientët me kancer në klinikën e onkologjisë, furnizimi kalon 90%. Megjithatë, ndodhin disa mungesa për shkak të ofertave të pakta nga operatorët.

Programi i trajtimit mjekësor jashtë institucioneve publike është thjeshtuar për qytetarët, duke përfshirë çmime referente dhe kompensimin 100% për personat me status invalid të luftës. Në fund të vitit 2023, është paguar një borxh prej 22 milion eurosh.

Ministria e Shëndetësisë ka nënshkruar marrëveshje për projektin "Shërbime shëndetësore të integruara" me vlerë 5.5 milion franga zvicerane, i fokusuar në sëmundjet jo ngjitëse dhe mbështetje për grupet e cenueshme. Një marrëveshje me Greqinë dhe Fondacionin për mjekësi fetale në Londër ka mundësuar trajnimin e profesionistëve shëndetësorë.

Ministria ka finalizuar një projekt për financimin e aktiviteteve të sistemit të informimit shëndetësor dhe ka përfituar donacione me vlerë 8,789,926.37 euro për barna, pajisje dhe materiale shpenzuese. Gjithashtu, Kosova është anëtarësuar në Komitetin për barna esenciale në Critical Medical Alliances, duke e forcuar angazhimin për përmirësimin e kujdesit shëndetësor.

Fatmire Kollçaku e falënderoi Ministrin për raportimin e detajuar dhe përgjigjet që ofroi për pyetjet e saj. Ajo theksoi rëndësinë e muajit të ndërgjegjësimit për diagnostifikimin e hershëm të kancerit të gjirit, duke e lidhur këtë iniciativë me slloganin "ta mposhtim së bashku kancerin". Kollçaku vuri në dukje reformat dhe investimet në sistemin shëndetësor, si dhe hapjen e shërbimeve të reja që po kontribuojnë në përmirësimin e shërbimeve për pacientët që frekuentojnë klinikat në QKUK.

Ajo theksoi nevojën për shtim të resurseve humane dhe edukim të vazhdueshëm për stafin në lidhje me përdorimin e aparaturave të reja. Kollçaku parashtrroi një pyetje në lidhje me statusin e fizikantëve mjekësorë në Klinikën e Onkologjisë, duke kërkuar informacion mbi përpjekjet për rregullimin e koeficientëve të tyre si staf deficitar.

Kryetarja përgëzoi punën në aspektin e infrastrukturës në QKUK dhe spitalet rajonale, duke e vënë re përmirësimin e dukshëm në pritoret. Ajo sugjeroi gjithashtu përmirësime në pritoren e kujdesit intensiv, si krijimin e bankave për familjarët e pacientëve në gjendje të rëndë shëndetësore.

Kollçaku theksoi se investimet kapitale në infrastrukturë janë përmirësime të mirëseardhura që ndihmojnë në parandalimin e infeksioneve intrahospitalore, të cilat janë të rëndësishme për ecurinë e suksesshme të intervenimeve. Ajo sugjeroi që Komisioni për parandalimin e infeksioneve intrahospitalore të funksionojë me intensitet të lartë për të përmirësuar më tej situatën.

Armend Zemaj theksoi se ekspozita e paraqitur nga ministri përfaqëson një raportim katërvjeçar mbi punën në shëndetësinë vendase, duke sugjeruar se ministri duhej të raportonte më shpesh, veçanërisht pas shkurtit të këtij viti, pasi që atëherë nuk kishte ndodhur ndonjë raportim.

Ai nënvizoi se Kuvendi tani ka një muaj funksional para se të hyjë në një fushatë zgjedhore, dhe se mandati i Ministrisë së Shëndetësisë po përfundon. Pas katër vjetësh, ai kërkoi që të diskutohej për reformën në shëndetësi, duke theksuar se kishte pasur shumë ndryshime të ministrave brenda Ministrisë së Shëndetësisë, gjë që kishte ndikuar negativisht në progresin e këtij sektori dhe legjislativitetit.

Zemaj adresoi disa kritika të rëndësishme:

Mos përmbushja e Agjendës Legjislative: Duke përmendur mungesën e projektligjit bazik për shëndetësinë dhe procedimin e vonuar të projektligjit për sigurimet shëndetësore.

Mospërmbushja e premtimit për funksionalizimin e SISH-it: Kjo ka penguar zhvillimin e sistemit të sigurimeve shëndetësore.

Shkelje ligjore: Duke lënë pozitat drejtuese me ushtrues detyre dhe duke mos miratuar raportin e punës së QKUK-së nga Bordi i SHSUK-së.

Ikja e mjekëve: Vërejtje për ikjen e mjekëve, veçanërisht të profileve deficitare, dhe mungesën e zgjidhjeve për këtë problem.

Shkelje të afateve ligjore: Në moszbatimin e Ligjit për çmimin e produkteve medicinale, si dhe gabimet në përcaktimin e listës zyrtare të çmimeve të barnave.

Dështimi në shërbime të reja: Këtu përfshihet mungesa e funksionalizimit të shërbimeve të implantologjisë dhe shërbimit të oksidulit, si dhe rritja e çmimeve për barna deri në 400%.

Çështja e resurseve njerëzore: Kritika mbi shkarkimet dhe emërimet e drejtorëve në klinika dhe spitale.

Tenderi për spitalin e Ferizajt: Kërkesa për transparencë në shpenzimet e miliona eurove dhe kush e ka dhënë tenderin.

Humbje të shpenzimeve kapitale: Dy vite të humbura në shpenzime kapitale në shumë komuna.

Parregullsi në fushën e specializimit: Këtu ai theksoi se pretendimet për mungesën e mentorëve për specializantët ishin të pavërteta.

Zemaj përfundoi duke theksuar se këto çështje kërkojnë një vëmendje të menjëhershme dhe veprime të qarta nga Ministria e Shëndetësisë për të përmirësuar situatën në sektorin shëndetësor.

Arben Vitia, ministri i Shëndetësisë, sqaroi se elaborati i tij nuk përfaqësonte vetëm katër vjet, por përfshinte gjithashtu investimet nga periudha e shkurtit 2024 deri në momentin aktual. Ai theksoi se mungesa e investimeve kapitale gjatë pandemisë COVID-19 kishte ndikuar në vonesat e aktiviteteve të planifikuara nga Qeveria, përfshirë agjendën legjislative.

Përsa i përket projektligjit për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor, Vitia nënvizoi se ai ndryshonte shumë nga ligji i vitit 2014, duke përmendur se fondi ishte krijuar në mënyrë jolegjitime dhe se kishte pasur mangësi që e kishin bërë të përealizueshëm. Ai shpjegoi se përpjekjet për të krijuar një sistem sigurimi shëndetësor ishin realizuar me eksperimente që kishin filluar në vitin 2010, por ishin ndaluar në vitin 2018, dhe kishte nevojë për një ekspertizë ndërkombëtare për të përmirësuar procesin.

Ministri kërkoi mbështetje nga deputetët për ratifikimin e marrëveshjes me Bankën Botërore, duke e quajtur këtë një hap të rëndësishëm për sistemin shëndetësor dhe për qytetarët e Kosovës.

Sa i përket ikjes së mjekëve, Vitia theksoi se numri i atyre që kishin aplikuar për licencë për të punuar në Kosovë ishte më i madh se ata që po largoheshin. Ai po ashtu diskutoi për sfidat e zbatimit të Ligjit për çmimin e produkteve medicinale, duke përmendur se kishte tendenca për të mbrojtur interesat e disa kompanive farmaceutike, por theksoi se nuk kishte kthim mbrapa në këtë proces.

Vitia gjithashtu u shpreh se stagnimi në shërbimin e implantologjisë kishte ardhur për shkak të ankesave për çmimin e lartë, por Ministria e Shëndetësisë kishte reaguar duke formuar një grup punues, dhe tani ishte në proces të finalizimit të një liste me çmime të reja, shumë më të ulta, duke përfshirë shërbime falas për disa nga to.

Armend Zemaj ngriti shqetësime lidhur me vendimin për përcaktimin e listës zyrtare të çmimit të barnave, i cili ishte anuluar më parë. Ai theksoi se kishte dyshime për një ndikim të mundshëm nga kompanitë e mëdha farmaceutike, duke aluduar se disa individë të përfshirë në këtë proces ishin të lidhur me këto kompani. Zemaj përmendi se ish-kryetari i Odës së Farmacisë kishte kaluar në një kompani farmaceutike që përfitonte miliona euro nga tenderët e Ministrisë së Shëndetësisë, dhe se kishte një lidhje të ngushtë mes personave të tjerë që ishin në pozita të rëndësishme dhe kompanive farmaceutike. Kjo situatë, sipas tij, ngrinte pyetje mbi transparencën dhe integritetin e procesit të caktimit të çmimeve të barnave.

Arben Vitia, ministri i Shëndetësisë, theksoi se asnjë nga këshilltarët e tij nuk është i lidhur me ndonjë kompani farmaceutike, duke sqaruar se ish-këshilltari Sami Ukë nuk ka qenë i përfshirë në listën e barnave. Ai nënvizoi se çdo akuzë për parregullsi dhe korrupsion duhet të adresohet në prokurori.

Sa i përket ndërtimit të Spitalit të Ferizajt, Vitia paraqiti një kronologji të situatës. Ai shpjegoi se në vitin 2016, Komuna e Ferizajt kishte paraqitur një projekt për ndërtimin e spitalit, por që kishte shumë mangësi dhe defekte, duke u ngjitur më shumë si projekt ideor sesa zbatues. Punimet nisën në vitin 2018, por Ministria e Shëndetësisë u përball me probleme, përfshirë

shfaqjen e ujërave në bodrumin e objektit, si rezultat i ndryshimit të lokacionit nga Komuna, pa ndonjë studim paraprak.

Ministri Arben Vitia shpjegoi se kompania “Arbëria Com” e cila ishte kontraktuar për ndërtimin e Spitalit të Ferizajt, dështoi në përmbushjen e detyrimeve kontraktuale, duke kërkuar pagesa shtesë dhe shkaktuar vonesa në procesin e ndërtimit. Për këto arsye, në fund të vitit 2021, kontrata u ndërpre dhe çështja u dërgua për hetim.

Në vitin 2022, për të siguruar cilësinë e objektit, Ministria bashkëpunoi me Fakultetin e Ndërtimtarisë për të bërë një vlerësim të strukturës ekzistuese, i cili zbuloi defekte të shumta. Si rezultat, vendimi u mor për një riprojektim të plotë të spitalit, me qëllim që çdo investim të ishte i sigurt dhe i qëndrueshëm.

Vitia njoftoi se, në mars 2024, u kontraktua riprojektimi i spitalit, me afatin për dorëzimin e projektit të zgjatur për 60 ditë për shkak të nevojës për të adresuar probleme të identifikuara. Ai theksoi se ky proces është i rëndësishëm për të garantuar cilësinë dhe sigurinë e objektit që do të ndërtohet për shëndetin e qytetarëve.

Më tej, ai diskutoi se situata me klinikën emergjente për COVID-19 ka sjellë probleme për shkak të ndryshimeve të nevojshme në projektim, dhe se aktualisht po bëhet një analizë e detajuar për të siguruar që ajo të jetë funksionale sipas nevojave të profesionistëve.

Sa i përket çështjeve të specializimeve dhe mentorimit, Vitia pranoi se ka pasur probleme historike me planifikimin dhe menaxhimin e resurseve njerëzore, duke theksuar se numri i mentorëve për specializantët nuk ka qenë i mjaftueshëm. Ai angazhohet për përmirësimin e këtyre aspekteve në të ardhmen.

Haxhi Avdyli shprehu miratimin për investimet kapitale në infrastrukturë dhe blerjen e aparaturave mjekësore, veçanërisht në klinikat e Gjinekologjisë, Urologjisë, Kirurgjisë Vaskulare dhe Neurologjisë. Ai theksoi se këto investime kanë kontribuar në rritjen e cilësisë së shërbimeve, duke lejuar që pacientët të marrin trajtim më të avancuar dhe të shmangin udhëtimet në vende të tjera të Evropës. Avdyli e ilustroi këtë me shembuj konkretë nga neurologjia, si aparaturën neuronaviagacion, KUSA dhe endoskopin, të cilat janë në përputhje me standardet më të larta europiane.

Sa i përket legjislacionit, ai theksoi rëndësinë e Projektligjit për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor, duke e cilësuar si një proces të dështuar deri tani, për shkak të faktorëve ekonomikë dhe ofrimit të shërbimeve. Avdyli shprehu optimizëm për implementimin e tij tani që janë bërë investime në infrastrukturë dhe cilësi shërbimesh.

Ai parashtrroi disa pyetje për të ardhmen e sistemit shëndetësor, duke kërkuar informacion mbi:

Riorganizimin e sistemit shëndetësor me Ligjin e Ri për Shëndetësi.

Inkorporimin e niveleve të shëndetësisë, sidomos përzgjedhjen e mjekut familjar në sistemin primar.

Stimulimin e kthimit të mjekëve nga jashtë dhe mundësitë për pagesa në bazë të performancës.

Planifikimet për buxhetin e shëndetësisë për vitin 2025.

Fillimin e shërbimeve për fertilizim të asistuar, duke iu referuar Udhëzimit Administrativ aktual dhe vështirësive që mund të hasen në implementim.

Këto pyetje sinjalizojnë shqetësimet dhe pritshmërinë për të ardhmen e sistemit shëndetësor në Kosovë, duke kërkuar një përgjigje të qartë dhe strategji për avancim.

Arben Vitia, ministër i Shëndetësisë, theksoi se investimet në infrastrukturë dhe aparatura janë të gjitha pjesë e përgatitjeve për zbatimin e Ligjit për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor dhe funksionalizimin e Fondit të Sigurimeve Shëndetësore. Ai shpjegoi se është e domosdoshme të ofrohet një nivel shërbimi adekuat për qytetarët përpara se t'u kërkohej një kontribut financiar prej 7% nga paga e tyre, sidomos në repartet që nuk kanë pasur investime për gati 30 vjet.

Vitia informoi se Projektligji për Shëndetësi ka kaluar në konsultimet paraprake dhe do të sjellët së shpejti në Kuvend. Ai theksoi rëndësinë e rregullimit të shërbimeve në kujdesin primar, sekondar dhe terciar, duke theksuar se referimet e shpeshta, shpesh të panevojshme, lidhen me mungesën e aparaturave dhe kushteve të nevojshme në spitalet e përgjithshme.

Për herë të parë, në buxhetin e vitit 2025 janë parashikuar kërkesa për investime në spitalet e përgjithshme, që do të ndihmojnë në zgjerimin e shërbimeve dhe rritjen e listës së barnave për kategori të caktuara.

Sa i përket Udhëzimit Administrativ për Ligjin për Fertilizimin e Asistuar, Vitia shpjegoi se nuk ka masa sanksionuese dhe se në vitet 2018-2019 ka pasur mbyllje të klinikave që ofronin këtë shërbim. Ai theksoi se vetëm miratimi i Projektligjit për Shëndetin Riprodhues dhe Fertilizimin e Asistuar do të mund të rregullojë këtë situatë dhe t'u mundësojë çifteve të realizojnë dëshirën për të qenë prindër.

Bekim Haxhiu, tha së në fund të mandatit do të duhej të prezantoheshin objektivat e realizuara të programit qeverisës në sektorin e shëndetësisë, sepse të punohet pa strategji të shëndetësisë dhe pa rregullimin e ligjeve bazike nënkupton një dështim të kësaj Qeverie, lidhur me këtë do të adresoj disa prej problemeve aktuale e për të cilat tha se i ka informata nga burime të ndryshme përbrenda SHSUK-së dhe QKUK-së, në bazë të raporteve zyrtare të publikuara apo përmes kërkesës së për qasje në dokumente zyrtare. Ai theksoi se si është e mundur që për 4 vite qeverisje të dështoj hartimi i Strategjisë së Shëndetësisë, dhe i Agjendës Legjislative, dështim në implementim dhe funksionalizim të sigurimeve shëndetësore dhe të SISH-it. Keqpërdorim dhe zhvatje e miliona euro -ve në blerje të aparaturave dhe në fasadime të objekteve spitalore. Problem i ikjes së personelit shëndetësor nuk mund të trajtohet në këtë formë duke paraqitur shifra se më shumë po kthehen se sa që po ikin. Abuzime dhe keqpërdorime me barna të cilën mund ti vlerësojmë si krim të organizuar për të mos e quajtur mafia farmaceutike. Punësime politike, nepotizëm, transfere jo të barabarta me dallim në koeficient për pozita të njëjta. Injorim i kërkesave të personelit teknik dhe administratës në QKUK si dhe injorim të kërkesave të infermiereve për pagesat e kujdestarisë. Raporti i auditorit për listat e pritjes së pacientëve me një numër të madh të vërejtjeve. Rritja e buxhetit për barna e në të njëjtën kohë mungesa e barnave po rritet. Në

Investimet në Klinikat e Gjinekologjisë, Urologjisë dhe ndërtimin e Nefrologjisë ka zhvatje të buxhetit, konflikt të pastër të interesit ku kompania e cila e ka fituar tenderin ka ofruar çmime abuzive me 200% më të larta se çmimet e tregut. Kompanitë fituese Argeprojekt, Engrup dhe

Shkëmbi e kanë fituar kontratën për renovim në Klinikën e Gjinekologjisë është në pronësi të një inxhinieri i cili punon në MASHT Bajram Beqiraj. Bekim Haxhiu theksoi se renovimi i Klinikës së Urologjisë është fituar nga kompania Euroservis Dotprojekt, e cila është në pronësi të Behxhet Rrukiqi, ushtrues detyre në Agjencinë Qendrore të Prokurimit. Ai theksoi se ky tender, si dhe ato për Klinikat e Gjinekologjisë dhe Nefrologjisë, janë në konflikt të pastër interesi dhe shkelin Ligjin e Prokurimit Publik. Haxhiu shprehu shqetësim për çmime abuzive të paraqitura në tenderë dhe kërkoi hetim nga prokuroria për këto parregullsi.

Ai gjithashtu raportoi se furnizimi me barna dhe material shpenzues është shumë i ulët, duke e vënë në dukje se në spitalin e Mitrovicës furnizimi është vetëm 34%. Haxhiu përmendi gjithashtu problemin e papunësisë së farmacistëve klinikë, pavarësisht se ky profesion konsiderohet deficit.

Duke folur për problemet në sistemin shëndetësor, ai theksoi se lista e pritjes për shërbime është rritur ndjeshëm krahasuar me vitet e kaluara, duke ofruar statistika shqetësuese për pritjet në klinika të ndryshme. Ai kritikoi gjithashtu menaxhimin e shërbimeve dhe u ndal në rastin e punësimit të infermierëve pa përvojë të mjaftueshme, duke theksuar se kishte dyshime për favorizime politike.

Haxhiu kërkoi përgjigje për disa pyetje, përfshirë ekzistencën e Komitetit të Shëndetësisë dhe shkarkimin e drejtoreshës së SISH-it, si dhe për vendimin për të sjellë pajisje dhe materiale nga klinika e traumatologjisë. Ai kërkoi transparencë dhe llogaridhënie për këto çështje, duke theksuar se situata aktuale kërkon një qasje më të fortë për të adresuar probleme thelbësore në sistemin shëndetësor.

Arben Vitia, ministër i Shëndetësisë, reagoi ndaj akuzave të Bekim Haxhiut, duke i cilësuar ato si të pavërteta dhe një përpjekje për të manipuluar opinionin publik. Ai theksoi se strategjitë për shëndetësi që kanë ekzistuar në të kaluarën nuk janë zbatuar nga asnjë qeveri, dhe se aktualisht po punohet për një strategji që do të jetë e zbatueshme dhe e përshtatshme për kushtet e tanishme.

Vitia sqaroi se situata për sigurimet shëndetësore është ndikuar nga ndryshimet globale, veçanërisht pas pandemisë, dhe se akuzat për keqpërdorime në investime janë të pabaza. Ai paraqiti një rast konkret të një klinike emergjente që ishte rinovuar, por ku punimet nuk ishin kryer siç duhej nga qeveritë e kaluara.

Duke folur për ikjen e mjekëve, Vitia e sfidoi Haxhiun, duke theksuar se numri i aplikimeve për licencim nga mjekët është në rritje dhe se të dhënat janë të verifikueshme. Ai po ashtu përmendi se ligjet dhe udhëzimet e reja kanë krijuar një ambient më të sigurt për të parandaluar abuzimet me barnat dhe se nepotizmi nuk ekziston në qeverinë e tij.

Ministri theksoi se furnizimi me barna dhe materiale shpenzuese është në nivelin më të mirë ndonjëherë, dhe se investimet në klinika janë financuar nga Banka Botërore, e cila ka procedura të veçanta për prokurim dhe implementim. Ai përfundoi duke kërkuar që çdo akuzë për keqpërdorim të adresohet në prokurori për hetim të mëtejshëm.

Ministri Arben Vitia vazhdoi të përgjigjet ndaj akuzave të bëra nga Bekim Haxhiu, duke sqaruar disa çështje të rëndësishme në lidhje me shëndetësinë. Ai theksoi se lista e pritjes për vitin 2019

ishite zero për shkak të referimeve në klinikat private, ku pacientët ishin dërguar për procedura që nuk ishin të mundura në sektorin publik, siç ishte rasti me stendimet dhe koronografitë. Vitia nënvizoi se këto klinika private kishin aksionarë nga skena politike, duke aluduar se kjo ndihmoi në reduktimin e pritjeve në sektorin publik.

Sa i përket shpërndarjes së barnave dhe materialeve shpenzuese në spitalin e Mitrovicës, ai tha se ky proces bazohet në kërkesat dhe nevojat e secilit spital. Vitia mohoi akuzat për diskriminim dhe theksoi se ka pasur bashkëpunim me kryetarin e Mitrovicës për të adresuar këto çështje.

Ministri reagoi ashpër ndaj pretendimeve për punësimin e infermierëve pa shkollë të mesme të mjekësisë, duke e cilësuar atë si një mega skandal që duhet të hetohet nga organet kompetente. Ai përmendi se repartet nuk mbyllen për arsyet e pretenduara, por për shkak të mungesës së mjekëve dhe pacientëve, dhe se Ministria e Shëndetësisë po punon për trajnimin e personelit mjekësor.

Vitia gjithashtu shpjegoi se shtretërit dhe pajisjet që ishin gjetur në depo do të shfrytëzoheshin, dhe se medikamenti Remdesivir ishte mbetur pa u përdorur pasi ishte siguruar gjatë pandemisë nga donatorët, pas kërkesave të shumta. Ai nënvizoi se këto çështje po adresoheshin dhe se Ministria është e angazhuar për të përmirësuar situatën në sistemin shëndetësor.

Mirsad Shkreta, duke u përgjigjur mbi mungesën e miratimit të Strategjisë së Shëndetësisë, theksoi se, megjithëse ka pasur dokumente strategjike në të kaluarën, rezultatet nuk kanë qenë të kënaqshme. Ai theksoi se për një dekadë, asnjë qeveri nuk ka miratuar ligje apo udhëzime për shëndetësinë, duke sugjeruar se nuk është e drejtë të kritikohet aktualja për çështje që lidhen me të kaluarën.

Shkreta nënvizoi se, përkundër problemeve të mëparshme, aktualisht shëndetësia është prioritet për këtë qeveri, siç tregon rritja e buxhetit për këtë sektor. Ai gjithashtu përmendi rritjen e listës esenciale të barnave, e cila është rritur me 80%, dhe shprehu besimin se implementimi i Ligjit për çmimin e produkteve medicinale do të lehtësojë barrën financiare për qytetarët.

Ministri shpjegoi se investimet e bëra nuk janë vetëm fasadë, por një nevojë thelbësore për të krijuar kushte për funksionimin e sistemit të sigurimeve shëndetësore. Ai vuri në dukje se proceset legjislative po përparojnë, me fokus në ligjin për çmimin e barnave dhe projektligjin për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor.

Në përfundim, Shkreta theksoi se është e rëndësishme të rregullohen diskrepancat mes burimeve njerëzore dhe kërkesave për shërbime, si dhe të krijohet një konkurrencë e ndershme mes sektorëve publik dhe privat për të përmirësuar shërbimin shëndetësor.

Shemsedin Dreshaj theksoi se diskursi i ministrit të Shëndetësisë, Arben Vitia, reflekton dy realitete të ndryshme: atë të situatës aktuale në terren dhe atë që po paraqitet në publik. Ai kritikoi ministrin për mungesën e veprimeve konkrete për të ndaluar ikjen e mjekëve nga vendi dhe për të kthyer profesionistët që janë jashtë.

Dreshaj e kritikoi gjithashtu procesin e miratimit të ligjeve në fushën e shëndetësisë, duke theksuar se shumë prej projektligjeve të rëndësishme për këtë sektor janë vonuar dhe se deri tani është sjellë vetëm një projektligj për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor. Ai theksoi se problemi nuk është te komisionet, por te politika dhe qeverisja aktuale.

Sa i përket sigurimeve shëndetësore, ai përmendi se për të nisur implementimin, duhet të plotësohen disa parakushtet, si sigurimi i objekteve dhe punësimi i stafit të trajnuar, dhe se numri aktual i të punësuarve është i pamjaftueshëm. Dreshaj solli shembuj nga vendet përreth për të ilustruar këtë mungesë.

Ai gjithashtu ngriti shqetësime për keqpërdorimet dhe menaxhimin e dobët të buxhetit të SISH-it, duke kërkuar transparencë në lidhje me masat e ndërmarra ndaj atyre që e kanë keqpërdorur.

Në fund, ai paraqiti disa pyetje për të cilat qytetarët kërkojnë përgjigje, përfshirë implementimin e procedurës IVF dhe mbylljen e repartit të infektives në spitalin e Mitrovicës, duke i kërkuar ministrit të reflektojë mbi situatën aktuale në shëndetësi dhe angazhimin e tij për përmirësim.

Arben Vitia, ministër i Shëndetësisë, theksoi disa nga hapat që janë ndërmarrë për të frenuar ikjen e mjekëve nga Kosova. Ai përmendi rinovimin e gjashtë klinikave si një element kyç, duke sugjeruar se nëse këto renovime do të ishin bërë më herët, do të kishin krijuar mundësi për përmirësime të tjera. Ai gjithashtu theksoi rritjen e pagave për mjekët, duke arritur deri në 3500 euro, si një masë inkurajuese.

Vitia diskutoi edhe nevojën për investime në infrastrukturë dhe aparaturë, që do të ndihmonin në krijimin e shërbimeve të reja dhe në avancimin e trajnimit për mjekët. Sa i përket Sigurimeve Shëndetësore, ai pranoi se janë të nevojshme objekte të reja dhe burime njerëzore, por theksoi që procesi duhet të jetë i mirëplanuar dhe me analizë të detajuar për të shmangur shpenzimet e panevojshme.

Ai sqaroi mbylljen e repartit të infektives në spitalin e Mitrovicës, duke shpjeguar se kjo ishte rezultat i numrit të ulët të pacientëve dhe kushteve të pamjaftueshme të trajtimit. Në përfundim, Vitia shprehu optimizëm për të ardhmen e shëndetësisë në Kosovë, duke theksuar se çdo problem po adresohet sistematikisht dhe se proceset e nisura do të vazhdojnë të avancojnë në mënyrë të pakthyeshme.

Labinotë Demi-Murtezi trajtoi disa çështje të rëndësishme lidhur me Projektligjin për shëndetin riprodhues dhe fertilizimin e asistuar. Ajo theksoi se, megjithë kontributin e deputetëve, asnjë variant i ligjit nuk ka arritur të sigurojë numrat e nevojshëm për miratim në Kuvend. Ajo njoftoi gjithashtu se plani i punës në Komision për sesionin vjeshtor është miratuar, por vështirësitë për miratimin e Projektligjit për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor janë të dukshme për shkak të afateve të zgjedhjeve.

Demi-Murtezi vuri në dukje rëndësinë e investimeve në klinika për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve, duke kërkuar gjithashtu që të punohet në reparte me numra të mëdhenj shtretërisht. Ajo bëri pyetje rreth organizimit të rregullores së punës së QKMF-ve dhe pozita e shefit të barnatores qendrore, duke kërkuar sqarime në lidhje me këtë.

Një çështje tjetër e ngritur ishte diagnoza e Fenilketonurisë, për të cilën kërkoi që Ministria e Shëndetësisë të sigurojë suplementin e nevojshëm që është i shtrenjtë. Ajo shprehu shqetësim për

mungesën e Rezonancës Magnetike në spitalin e Gjilanit, e cila është shumë e nevojshme për regjionin Ana Moravës dhe shpresoi që të planifikohet për vitin 2025.

Përfundimisht, Demi-Murtezi pyeti për masat disiplinore të marra ndaj rastit kur një deputete ishte e pranishme kur stafi u kërkoi të blinte një preparat nga depoja farmaceutike. Kjo tregon një angazhim për transparencë dhe përgjegjshmëri në menaxhimin e burimeve shëndetësore.

Arben Vitia, ministër i Shëndetësisë, sqaroi disa çështje të rëndësishme lidhur me organizimin e QKMF-së dhe sigurimin e barnave për sëmundjet e rralla. Ai pranoi se kishte ndodhur ndonjë gabim teknik në mungesën e pozitës së shefit të Barnatores Qendrore dhe tha se do ta verifikonte këtë situatë, duke theksuar se nuk mund të jepte një përgjigje të saktë në atë moment.

Në lidhje me sigurimin e barnave për sëmundjet e rralla, Vitia shpjegoi se një komision i caktuar është përgjegjës për plotësimin e listës në përputhje me kërkesat dhe analizat e bëra. Ai gjithashtu përmendi papërgjegjshmërinë e disa individëve që nuk ofrojnë barnat që janë të disponueshme në depo, duke theksuar se ka ndodhur disa herë. Ai inkurajoi qytetarët që të lajmërojnë organet kompetente nëse vërejnë raste të tilla, për të siguruar që çdo problem të trajtohet në mënyrë të duhur.

Floretë Zejnullahu ngriti çështje të rëndësishme në lidhje me Raportin e Progresit të BE-së, ku theksoi se Kosova nuk ka arritur përparim në fushën e shëndetësisë. Ajo e theksoi raportin e Zyres Kombëtare të Auditimit, që identifikon probleme të shumta rreth shpenzimeve dhe pagesave në sektorin shëndetësor.

Zejnullahu gjithashtu shprehu shqetësim për vonesat në ardhjen e projektligjeve të parashikuara në Programin Legjislativ të Qeverisë për vitin 2024, duke theksuar se projektligjet e paraqitura në fund të mandatit kanë për qëllim kryesisht të plotësojnë numrin e kërkuar, pa mundësi reale për shqyrtim dhe amendamentim në këtë periudhë të shkurtër. Ajo theksoi se kjo situatë e bën të vështirë miratimin e ligjeve të nevojshme, sidomos kur Kuvendi pritet të humbasë funksionalitetin e tij për shkak të zgjedhjeve.

Ajo u shpreh për shqetësime të tjera që prekin shëndetësinë, si mungesa e farmacistëve klinikë në repartet e QKUK-së, situata e pazgjdhur e ekspertëve të Fizikës Mjekësore në Klinikën Onkologjike, mungesa e barnave, listat e gjata të pritjes, dhe ikja e mjekëve. Ajo kërkoi informacion në lidhje me matjen e performancës së mjekëve specialistë kirurgë, duke e parë këtë si një aspekt të rëndësishëm për përmirësimin e shërbimeve shëndetësore.

Arben Vitia, ministër i Shëndetësisë, sqaroi disa çështje të rëndësishme lidhur me raportin e auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit. Ai theksoi se keq menaxhimi i buxhetit është një çështje serioze dhe se është obligim i Prokurorisë së Shtetit të nisë hetime për këtë situatë.

Në lidhje me ekspertët e Fizikës Mjekësore në Klinikën Onkologjike, Vitia shpjegoi se ata nuk kanë mundur të përfshihen në Ligjin për pagat e sektorit publik si një kategori e njohur, çka ka shkaktuar mangësi në rregullimin e pagave për këtë grup. Ai theksoi se do të bëhet përpjekje për të rregulluar këtë çështje përmes një udhëzimi administrativ që do të adresojë kategoritë deficitare.

Mbi performancën e mjekëve specialistë kirurgë, Vitia tha se është e rëndësishme që të hartohet një plan të detajuar për vlerësimin e tyre, duke e parë këtë si një proces që kërkon kohë dhe përgatitje të mirë për zbatimin e tij.

Fatmire Kollçaku, e falënderoi ministrin për gjitha sqarimet dhe përgjigjet e dhëna në mënyrë të detajuar edhe pse gjatë diskutimit të kësaj mbledhje pothuajse u përsëritën disa here gjërat e njëjtat më çështje dhe pyetje por pavarësisht mbledhjes së gjatë të gjithë deputetëve ju dha fjala për diskutim dhe pyetje. Po ashtu nga ana e ministrit z. Vitia, u sqaruan edhe dilemat sa i përket renovimeve të disa klinikave të QKUK-së, siç është rasti disa reparteve në Gjinekologji që u ngarkuan disa reparte por kjo ishte e pashmangshme për kohën sa zgjatën renovimet dhe se tani do ta kenë më lehtë pas lirit të repartit të vjetër të ortopedisë i cili do të shërbejë për pacientët e repartit të ardhshëm i cili do të rinovohet. Gjithashtu u përsëriten sfidat për zbatimin të ligjeve të cilat do të vazhdojnë dhe në ndonjë moment mund të shkaktojnë ngecje por me rëndësi është se gjërat po bien në binarët e duhur dhe puna sistematike e zgjidhjes së problemeve do të vazhdoi në ofrimin e shërbimeve mjekësor që të jen sa më cilësor, dhe rezultatet do mbesin për periudha më afatgjate.

Të ndryshme.

Për pikën të ndryshme nuk pati ndonjë çështje për diskutim.

Mbledhja përfundoi në orën 14:30.

E përgatiti: Stafi mbështetës i Komisionit.

Fatmire Kollçaku,

Kryetare e Komisioni
